




shkollore mund t'ju duhet të mbledhin të dhëna të caktuara në pajtueshmëri me ligjeve shtetërore dhe/ose federale, ne kemi këshilluar gjithashtu që ato duhet ta kmië

tjerë federalë të emigrimit paraqiten në shkollë dhe kërkojnë të takojnë studentët (për intervista dhe/ose marrje në pyetje), distrikti shkollor duhet të këshillojë të gjithë stafin që të kontaktojë menjëherë përgjegjësën dhe përfaqësuesin ligjor të distriktit shkollor për udhëzime, veçanërisht në lidhje me detyrimet e tij sipas ligjit "Për arsimin", *Plyler*, si dhe "NYFCA" përpara se të autorizojnë takimin me një student.

*Kërkesat për akses në të dhënat e studentëve.* Në mënyrë të ngjashme, agjencitë tona këshillojnë që, pas marrjes së një kërkesë nga zyrtarët e emigracionit për akses në të dhënat e shkollimit të studentëve, distriktet shkollore duhet të konsultohen menjëherë me përfaqësuesit e tyre ligjorë, duke qenë se pajtueshmëria me këtë kërkesë nëpërmjet zbulimit të informacionit mund të përbëjë shkelje të "FERPA".<sup>6</sup> Në përgjithësi, "FERPA" ndalon dhënien e informacioneve identifikuese personale (Personally Identifiable Information, "PII"), të cilat gjenden në regjistrat shkollorë të studentëve, nga distriktet shkollore që marrin fonde federale, pa pëlqimin e prindit apo studentit të zgjedhur. "FERPA" e lejon zbulimin e këtij informacioni pa pëlqim vetëm nëse ai përmbush disa kushte të kufizuara të përcaktuara në rregulloret e zbatimit të ligjit. Këto kushte të kufizuara përfshijnë kërkesat e bëra nga individë të veçantë të qeverisë federale.<sup>7</sup>



MaryEllen Elia  
Komisionere për Arsimin



Eric T. Schneiderman  
Prokuror i Përgjithshëm